



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 875/3 prot.

Tiranë, më 21.03.2019

VENDIM

Nr. 22, datë 21.03.2019

PËR  
DHËNIE MASE DISIPLINORE

Bordi i Administrimit të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, në mbledhjen e datës 21.03.2019, me pesë vota pro dhe një votë kundër të anëtarëve të pranishëm, pas paralajmërimeve dhe diskutimeve të përsëritura në mënyrë verbale në mbledhjet që Administratori ka qenë i ftuar, dhe duke i dhënë mundësi atij të paraqesë mbrojtjen pranë Bordit të Administrimit, rreth shkaqeve objekt diskutimi, për arsye të:

1. Moszbatimit në mënyrë të përsëritur dhe pa shkaqe të arsyeshme të vendimeve të Bordit të Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, konkretisht, Vendimi nr. 18 dhe Vendimi nr. 19, datë 26.02.2019.

2. Realizimit të procedurave të punësimit të personelit administrativ, në kuptim të pikës 4 të Udhëzimit Nr. 27, datë 29.12.2017 "*Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë*", në shkelje të nenit 49 germa "F" të Ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", pa kërkuar më parë miratimin e kritereve dhe të procedurës nga Bordi i Administrimit, duke sjellë për pasojë punësim të personelit me një procedurë të paligjshme.

2.1. Për këtë pikë, Bordi i Administrimit, në bazë të nenit 113, të nenit 111, të nenit 110, dhe të nenit 108 germa "a" pika "ii" të Kodit të Procedurave Administrative, i konstaton absolutisht të pavlefshëm urdhrat e emërimeve të nxjerra në kundërshtim me procedurën ligjore, për personelin e emëruar nga muaji Janar 2018 deri në Janar 2019.

2.2. Administratori dhe Sektori i Burimeve Njerëzore të kryejnë njoftimet e personelit duke respektuar afatet e nenit 143 e vijim të Kodit të Punës, dhe të rihapë procedurat e punësimit duke respektuar nenin 49 germa "F" të Ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSh*".

3. Të marrjes së funksionit dhe përgjegjësisë të "Nëpunësit Autorizues" dhe të "Administratorit" të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike të Universitetit të



Mjekësisë, Tiranë, në shkelje të pikës 5 të nenit 51 të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe pa miratim paraprak nga Bordi i Administrimit.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 49 të Ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Bordi i Administrimit i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

#### VENDOSI:

1. Z. Andi Mahila, Administrator i Universitetit të Mjekësisë Tiranë, i jepet masa disiplinore “Paralajmërim për shkarkimin nga detyra”.
2. Ky vendim depozitohet në dosjen e Z. Andi Mahila, pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore.
3. Ngarkohet Sektori i Burimeve Njerëzore pranë Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Për zbatimin dhe rregullimin e pasojave të konstatuara, të raportohet pranë Bordit të Administrimit nga Administratori dhe nga Sektori i Burimeve Njerëzore brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

*Ky vendim hynë në fuqi menjëherë dhe i njoftohet Z. Andi Mahila.*

**KRYETARI**

**Adriana BERBERI**

